

## **SILLABUS I LËNDËS**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Edukimit- MA Edukimi Inkluziv</b>
Titulli i lëndës:	<b>Metodat e Hulumtimit</b>
Niveli:	<b>Master</b>
Statusi lëndës:	<b>Obligative</b>
Viti i studimeve:	<b>Viti I<sup>rë</sup></b>
Numri i orëve në javë:	<b>2+2</b>
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	<b>Blerta Perolli Shehu, PhDC.</b>
Detajet kontaktuese:	<b>blerta.perolli-shehu@uni-pr.edu;</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kursi ka për qëllim aftësimin e studenteve me elementet kryesore të procesit të hulumtimit në fushën e edukimit e më konkretisht në fushën e edukimit inkluziv. Kursi trajton metodat kualitative, kuantitative dhe të përziera të hulumtimeve arsimore. Në mënyrë të tërthortë kursi trajton llojet e ndryshme të hulumtimeve si përshkruese, historike, eksperimentale, vlerësuese, vepruese, studim rasti etj. Në kuptim më të ngushtë, kursi ndihmon studentët të familjarizohen me konceptin e zgjedhjes dhe definimit të problemit dhe formulimin e problemit të hulumtimit dhe pyetjeve të hulumtimit, hipotezave, përcaktimin e mostrës, rishikimin e literaturës, përcaktimin e të dhënave që nevojiten për realizimin e një projekti hulumtues hartimin e instrumenteve dhe mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore, si dhe procesimin, analizën dhe raportimin e të dhënave dhe gjejtjeve të një studimi. Në kuptim më të përgjithshëm, kursi ndihmon studentët të reflektojnë rreth parimeve etike ligjore dhe filozofike të realizimit të një projekti hulumtues si psh hulumtueshmëria, besueshmëria, validiteti, përgjithësimi dhe ruajtja e anonimitetit. Natyra e temave dhe problematikës që do të adresojë kursi do të jenë në përputhje me natyrën e programit dhe si të tilla do të orientojnë studentët edhe drejt kuptimit të problemeve dhe qëstjeve kryesore brenda fushës së ngushtë të programit.</p>

<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i këtij programi është prezantimi i konceptit të hulumtimit në arsim dhe i elementeve kyçe që përfshihen në procesin e hulumtimit		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Me përfundimin e kursit, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të identifikojnë problemin e hulumtimit dhe të hartojnë pyetjet e hulumtimit, hipotezat dhe objektivat e hulumtimeve;</li> <li>- të kuptojnë dhe të realizojnë lloje të ndryshme të projekteve hulumtuese sasiore dhe/apo cilësore (psh hulumtimet eksperimentale, longitudinale, etnografike, historike, fenomenologjike, vlerësuese, vepruese si dhe studimet e rastit);</li> <li>- të identifikojnë dhe hartojnë instrumentet të ndryshme për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore;</li> <li>- të analizojnë, interpretojnë dhe raportojnë të dhënat sasiore dhe cilësore në një projekt studimor;</li> <li>- kuptojnë aspektet kryesore etike dhe metodologjike (si validiteti, besueshmëria, përgjithësimi) të realizimit të nje projekti hulumtues.</li> <li>- Të zhvillojnë projektin studimor në tërësi</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	10	20
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	2	30	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	45		45
Përgaditja përfundimtare për provim	15		15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4		4
Projektet,prezentimet ,etj	4		4
<b>Totali</b>			<b>180</b>

--	--	--	--

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	
	<p>Në këtë kurs do të zbatohen metodat ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat u mundësojnë studentëve të angazhohen në diskutime, të reflektojnë mbi përvojën e tyre dhe proceset e hulumtimeve arsimore, të shprehin idetë e tyre, besimet, dhe përvojat rreth temave të caktuara në kontekst të praktikave të tyre arsimore në klasë/shkollë dhe më gjërë në sistem.</p> <p>Në masë të madhe kursi mundëson punën ekipore dhe ndërveprimin mes kolegëve për të arritur rezultate efektive.</p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi do të jetë i vazhdueshëm nga java e tretë deri në përfundim- studentët do të sjellin detyrat javore të cilat i marrin në klasë cdo javë.</p> <p>Vlerësimi final bëhet me projekt propozimin e përfunduar që studentët e dorëzojnë në fund të kursit.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p>[1] Mattheus, B. &amp; Ross, L.: <i>Metodat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale e humane</i>, Qendra për Arsim Demokratik (CDE), Tiranë, 2010.</p> <p>[2] Creswell, J. W.: <i>Educational research, planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research</i> (3rd ed.). Upper Saddle Creek, NJ: Pearson Education, 2008.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>[3] Kocani, A.: <i>Ushtrime me metodat e kërkimit sasior në shkencat sociale</i>, Ufo Press, Tiranë, 2008.</p> <p>[4] Creswell, J. W.: <i>Mixed methods research</i>. Thousand Oaks: Sage Publications, 2007.</p> <p>[5] Creswell, J. W.: <i>Qualitative inquiry and research design: choosing among five traditions</i>. Thousand Oaks: Sage Publications, 1998.</p> <p>[6] Cohen, L., Manion, L. &amp; Morrison, K.: <i>Research Methods in Education</i>. (6th edition). Routledge London, 2007.</p>

[7] Patton, Q. M. : Qualitative Research & Evaluation Methods. 3d ed. Sage Publication. Inc, 2002.

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<b>Java e parë:</b>	Prezantimi i kursit Paraqitja e syllabusit dhe detyrave
<b>Java e dytë:</b>	Hyrje në hulumtimet arsimore. Njohuritë/dijet dhe këndvështrimet për hulumtimet arsimore
<b>Java e tretë:</b>	Llojet e hulumtimeve Procesi i hulumtimit
<b>Java e katërt:</b>	Planifikimi i një hulumtimit, formulimi i qëllimit, të dhënat, pyetjet e hulumtimit, hipotezat Shkrimi i një projekt propozimi
<b>Java e pestë:</b>	Shqyrtimi i literaturës
<b>Java e gjashtë:</b>	Identifikimi i variablave Formulimi i pyetjeve të hulumtimit dhe hipotezave
<b>Java e shtatë:</b>	Përzgjedhja e modelit të hulumtimit
<b>Java e tetë:</b>	Instrumentet e mbledhjes së të dhënave
<b>Java e nëntë:</b>	Populacioni dhe mostra Metodat e zgjedhjes së mostrës
<b>Java e dhjetë:</b>	Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Abstrakti, Konkludimi, Diskutimi
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Citimet dhe referencat
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Paraqitja e hulumtimeve në formë të artikujve shkencor
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Prezantimet e projektpropozimeve të hulumtimeve
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Prezantimet e projektpropozimeve të hulumtimeve

#### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

##### ***Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.***

- *Studentët janë të obliguar të jenë të pranishëm në të gjitha ligjeratat dhe ushtrimet. Studentët janë të obliguar të respektojnë kohën e fillimit të ligjeratave dhe shkyqjen e telefonave mobil.*
- *Secila mungesë e paarsyeshme do të mirret parasysh, dhe nëse studenti ka më shumë se tri mungesa do të ndikojnë në vlerësim dhe nuk do të ketë të drejtë të merr pjesë në provim.*
- *Studentët inkurajohen të participojnë në ushtrime duke shtruar pyetje, përgjigjur në pyetje, duke dhënë ide, mendime, komente dhe duke kontribuar në mësimin e lëndës. Një pjesëmarrje e tillë pozitive dhe aktive do të rezultojë pozitivisht në notën përfundimtare.*

- *Studentët do të vleresohen me provime gjysëm-semesterale, punime, prezentime, seminare si dhe detyra tjera që do të jipen gjatë semestrit. Kryerja e këtyre punimeve do të shpërblehet në notën përfundimtare*
- *Studentët janë të obliguar të marrin pjesë në ushtrime dhe të lexojnë kapitujt paraprakisht. Ushtrimet do të organizohen në formë të diskutimeve, punëve në grupe, si dhe seminareve. Pritet një pjesëmarrje aktive si në diskutime dhe punë grupore. Në ushtrime do të diskutohen temat e ligjëruara, si dhe do të plotësohen në ushtrime përmes artikujve të ndryshëm shkencor dhe literaturës plotësuese.*
- *Studentët janë të obliguar të respektojnë kolegët gjatë punës grupore dhe diskutimeve dhe të respektojnë këndvështrimet dhe mendimit e secilit student në vete.*